



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:228437

Datë: 06.06.2022

Numri i dokumentit: 03101870

K.nr.1016/21

GJYKATA THEMELORE-DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË GJILAN, përmes gjyqtarit Menderes Behluli dhe zyrtares ligjore Erzë Mustafa, duke vendosur në lëndën për kundërvajtje ndaj të pandehurit B.S nga fsh.P... K.Gjilan, për shkak të veprës kundërvajtëse, të parashikuar dhe të ndëshkuar nga neni 5 paragrafi 1 të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike Nr.03/L-142, sipas kërkesës së Stacionit Policor, Qendra në Gjilan **nr.2021-CA-...** të datës **30.09.2021**, e në bazë të nenit 55 pika 1 dhe 2, 86, 119 dhe 124, të Ligjit mbi Kundërvajtjet më datë **06.06.2022**, mori këtë.

A K T G J Y K I M

I pandehuri B. S, nga babai S..., i lindur më ..., me vendbanim në fsh.P... K.Gjilan, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i 4 fëmijëve, me gjendje të dobët ekonomike.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse më datën **30.09.2021**, rreth orës **10:30** min, pasi kemi arritur në vendin e ngjarjes, para SH.F “Sveti Sava”, kemi takuar drejtorin e shkollës, Millovan Stajiq, i cili shkurtimisht na ka thënë se ka problem me një punëtor ndihmës, B.r S, i cili verbalisht e kishte ofenduar dhe përveq këtij ai kishte ofenduar dhe disa tjerë të punësuar në shkollë. Pasi kemi hyrë në shkollë, në koridor kemi takuar personin e lajmëruar Bozhidar Stajiq, me të cilin kemi tentuar të zhvillojmë bisedë në një klasë aty në shkollë, por i njejt i filloi të flas me zë të lartë dhe refuzoi të bashkëpunoj, kështu kishte dyshime se i njejt është nën ndikimin e alkoolit dhe pas grumbullimit të gjitha informacioneve lidhur me rastin e B. S, kemi kërkuar që i njejt të vijë me ne deri në stacionin policor për të marr deklaratën e tij. I njejt refuzoi urdhërin dhe nuk desh të hyjë në veturë dhe verbalisht e shante patrullën policore dhe pasi që disa herë refuzoi të hyjë në vetyrën zyrtare kemi qenë të detyruar që të njejtit ti vendosim pranga dhe ta ulim në ulësen e pasme të veturës.

Më të arritur në Stacionin e policisë të njëjtit i është bërë alkotesti dhe në ora 11:30 minuta testi tregoi se i njëjti kishte alkool në gjak 2.50 % promila dhe ishte e pamundur që prej tij të merret deklarata. Të njëjti i është bërë edhe alkotesti i dytë në ora 13:42 i cili ka treguar se i njëjti në gjak kishte alkool 2.33 % promila, për çka ne ende e kishim të ndaluar të merrnim deklaratën e tij lidhur me rrethanat se di ka ndodhur rasti.

-me çka ka bërë veprë kundërvajtëse- të parashikuar dhe të ndëshkuar nga neni 5 paragrafi 1 të Ligjit për Rëndin dhe Qetësinë Publike Nr.03/L -142 ,

Prandaj, në bazë të dispozitës së cekur më lartë shpallet përgjegjës dhe

D Ë N O H E T

ME **DËNIM GJOBE**, në shumë prej **60 (gjashtëdhjetë) €**, të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor t'i paguajë kësaj gjykate shumë prej **5 euro** në afat të njëjtë si edhe dënimin.

Nga një kopje e aktgjykimit t'iu dorëzohet palëve në procedurë.

A r s y e t i m

Stacioni Policor - Gjilan, ka parashtruar kërkesën me **nr.2021-CA-....** të datës **30.09.2021**, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartcekur, për shkak të veprës kundërvajtëse të parashikuar dhe të ndëshkuar nga neni 5 paragrafi 1 të Ligjit për Rëndin dhe Qetësinë Publike Nr.03/L-142, dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpall përgjegjës dhe të dënohen sipas ligjit.

Gjyqtari për vërtetimin e gjendjes faktike mori në pyetje të pandehurin.

I pandehuri në deklaratën e dhënë në seancën gjyqësore lidhur me kundërvajtjen thekson se është e vërtetë se me datën **30.09.2021** në ora **10:30** min, në objektin shkollor "Sveti Sava" në fsh.Ponesh, pasi që e kishte pastruar zyren e drejtorit dhe vërtetë i kishte pirë dy gota raki nga rakia e drejtorit dhe me të vërejtur drejtori ka filluar t'i bërtas dhe ta ofendoj duke shtuar se i njëjti nuk ka reaguar fare dhe pastaj drejtori i ka thirrur policinë dhe kjo ka qenë e tëra andaj edhe kërkon ndjesë, kërkon falje dhe me që me shëndet nuk qendron mirë me cka i paraqet edhe provat materiale, vërtetimet mjeksore në shkresat e lëndës, lut gjykatën që kësaj here mundësisht ti mer parasysh këto rrethana si lehtësuese dhe me rastin e vendosjes t'i shqiptoj një dënim sa më minimal dhe se në të ardhmen nuk do të ketë kurfar problemi me cka edhe me të njëjtin janë pajtuar.

Gjyqtari pasi shikoi dhe analizoi kërkesën e Stacionit Policor, deklaratën e të pandehurit dhe shkresat e tjera të lëndës, erdhi në përfundim se vërtetë në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elemente të veprës kundërvajtëse nga neni 5 paragrafi 1 të Ligjit mbi RQP-së dhe të pandehurit i shqiptohet dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit mori për bazë të gjitha rrethanat, lehtësuese dhe rënduese komfor nenit 31 paragrafi 1 të LMK-së dhe të pandehurit i shqiptoi këtë dënim nën minimumin e paraparë ligjor konform nenit 35 të LMK-së, duke menduar se edhe me një dënim të këtillë do të arrihet qëllimi i dënimit që i pandehuri në të ardhmen mos të përsëris vepra të tilla kundërvajtëse.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë në mbështetje të nenit 59 të ligjit mbi kundërvajtjet. Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PËR KUNDËRVAJTJE NË GJILAN
Më datë 06.06.2022

Zyrtarja ligjore,
Erzë Mustafa

Gjyqtari,
Menderes Behluli

UDHËZIME MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit për Kundërvajtje në Prishtinë.